

E 40 të jetëndërrimit të Mitropolitit të Gjirokastrës Hirësi Dhimitrit



40 ditë nga jetëndërrimi i Hirësisë së Tij, Mitropolitit të Gjirokastrës Hirësi Dhimitrit – Kujtim i një jete në shërbim të Zotit dhe grigjës që Kisha e Shenjtë i besoi Sot, kur mbushen 40 ditë nga jetëndërrimi i Hirësisë së Tij, Mitropolitit të Gjirokastrës, Z. Dhimitër, zemrat tona mbeten ende të trazuara, por të mbushura me mirënjohje të thellë për jetën e tij shembullore dhe shërbimin e palodhur ndaj Kishës dhe komunitetit.

Hirësia e Tij ishte më shumë se një figurë shpirtërore. Ai ishte një udhërrëfyes i heshtur, një zë paqësor në kohë trazirash, një dorë e zgjatur drejt kujtqë kishte nevojë – qoftë për fjalë shprese, qoftë për mbështetje shpirtërore, apo thjesht për një buzëqeshje që ngrohte zemrën.

I rritur dhe i formuar në besim të palëkundur, me një përvojë të thellë shpirtërore, i kultivuar në një prej manastireve më në zë të Orthodhoksisë në Malin Sinai, Mitropoli Dhimitër mishëronte përlësinë, urtësinë dhe dashurinë për njeriun. Gjatë viteve të shërbimit të tij në krye të Mitropolisë së Gjirokastrës, ai mbeti gjithnjë pranë njerëzve, duke ndërtuar ura, jo mure, duke frymëzuar dialog, jo

ndasi, duke folur me vepra, jo me fjalë boshe dhe të kota.

Në kujtesën e të gjithëve që patën fatin ta njihnin nga afër, ai do të mbetet si një bari i mirë, që nuk kërkoi lavdi apo pushtet, por që zgjodhi të jetojë me thjeshtësi dhe përlulesi dhe të përçojë dritën e besimit edhe në skutat më të errëta të shoqërisë sonë.

Kujtimi i tij nuk do të zbehet. Mes rreshtave të heshtjes që lë pas, dëgjohet ende zëri i tij i butë, që këshillonte me urtësi e ngushëllonte me dashuri. Mitropolia e Gjirokastrës humbi një Hierark të përkushtuar, por fitoi një ndërmjetës të përjetshëm përpara Zotit.

Pikërisht në këtë ditë u zhvilluan Shërbesat e Shenjta dhe Përshpirtja në kujtim të tij në katedralen “Ngjallja e Krishtit” në Gjirokastrë. Ishte vet Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit edhe gjithë Shqipërisë Imzot Joani që i drejtoi këto Shërbesa së bashku me Anëtarët e Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

Në mbyllje të Liturgjisë Hyjnore Kryepiskopi Joan ndër të tjera theksoi:

“Sot jemi mbledhur për të 40-at e vëllait tonë të fjetur dhe bashkëmeshtarit tonë kryepiftit Dhimitër dhe arsyeja që Kisha mbledhet dhe lutet është shumë e rëndësishme. Sa herë që bëjmë Përkujtimore ndalemi dhe rikujtojmë përsëri përse mbledhemi.

Fillimisht mbledhemi sepse ne i duam. Njerëzit të cilët i kemi patur të afërm i duam dhe lutemi për ta dhe ne e dimë që njerëzit janë qenie komunitare, tek Perëndia nuk ka të vdekur, të gjithë janë të gjallë. Ata luten për ne dhe ne lutemi për ta.

Lutemi dhe i përkujtojmë ata sepse e dimë se Perëndia është i shumëshirshën, çfarëdolloj gabime që të kenë bërë me vepra dhe fjalë, me dashje dhe padashje, lutja e Kishës ka fuqi shumë të madhe. Historia e Kishës sonë është e mbushur me mijëra raste të tilla. Është rasti i martires së Madhe Perpetua që vëllai i saj Dimokrati kishte ndërruar jetë dhe i ishte shfaqur që nuk ishte i qetë atje ku qëndronte dhe shenjtorja u lut me zjarr, aq shumë sa Perëndia i tregoi që i ishin falur të gjitha fajet që ai kishte bërë. Prandaj edhe ne lutemi.

I lutemi Zotit që të jetë i mëshirshëm.

Edhe kemi një histori tjetër shumë të bukur për Shën Athanasinë e Egjinës, e cila rrinte në një manastir shumë të dëgjuar, mrekulli ishin bërë kur ishte ende gjallë dhe shumë mrekulli u bënë dhe mbas fjetjes së saj.

Përpara se të ndërronte jetë i kishte paralajmëruar motrat e saj që kur unë të ndërroj jetë do bëni 40 ditë meshim dhe do ndani lëmosha tek të gjithë dhe i lutem priftërinjve që të luten për mua.

Motrat harruan. U lutën për 9 ditë pastaj e ndërprejnë. Edhe shenjtorja ju shfaq atyre dhe u tha përse nuk keni ruajtur amanetin tim. Nuk e dini që lutjet e priftërinjve dhe lëmoshat që bëni për të varfrit kanë një fuqi shumë të madhe tek Perëndia, i cili mund të fali dhe fajet e mëdha të shumë njerëzve. Nguli shkopin që

kishte në tokë dhe u zhduk atyre. Të nesërmen motrat panë që shkopi kishte mbirë dhe kishte dhënë dhe fruta, si një shenjë mrekullie për të vërtetuar fjalët e saj. Dhe ju thotë dhe këto fjalë shumë të rëndësishme që janë dhe për ne sot:

Lutuni për ata që kanë fjetur, edhe nëse ata nuk kanë nevojë për lutjet tuaja, lutjet tuaja do kthehen për bekimin tuaj, nëse ata kanë nevojë do të kthehen për bekimin e tyre, prandaj edhe ne lutemi vazhdimisht.

Dhe pika tjetër e rëndësishme që është na tregon që kemi një dimension tjetër, kemi dhe përjetësinë. Te Zoti nuk ka të vdekur prandaj edhe Ngjallja e Krishtit e ndryshoi raportin me vdekjen. Nuk trembemi më, as nuk krijon vdekja hidhërim shumë të madh. Prandaj Shën Pavli na porosit: 'Mos u bëni si ata që s'kanë shpresë'. Ne besojmë që ata që janë ndarë prej nesh nuk janë të vdekur por të gjallë te Perëndia dhe ky është besimi më i madh. Dhe kjo është fitorja më e madhe që ka krishtërimi.

Me të drejtë Shën Nikolai i Ohrit thoshte këto fjalë: Çdo fitore tjetër është e pjesshme. Fiton një komb, hidhërohet kombi tjetër. Fiton një parti, hidhërohet partia tjetër. E vetmja fitore që është për të gjithë njerëzit është fitorja e Krishtit mbi vdekjen. Sepse vdekja është armiku i përbashkët i gjithë njerëzve, prandaj edhe ne mblidhemi. Kujtojmë dhe vdekjen siç thoshin etërit e kishës që vdekja është mësuesi më i mirë sepse një njeri që ka parasysh që një ditë do e mbarojë këtë jetë nuk mund të bëjë shumë mëkate të mëdha dhe do largohet nga shumë gjëra të tjera sepse jeta jonë nuk mbaron me vdekjen. Madje jeta është një parathënie. Jeta e vërtetë është pas, kjo është shpresa që kemi ne dhe kjo është shpresa e gjithë të krishterëve. Lutemi sot për shpirtin e vëllait tonë, bashkëmeshtarit të ndjerë kryepiftit Dhimitër që Perëndia ta ndjejë dhe ta vendosi në tendat e të drejtëve. Kemi besim që ai është pranë Perëndisë dhe lutet për ne. Dalëngadalë janë shtuar shumë njerëz që luten për ne; Fjetja e Kryepiskopit Anastas, Mitropolitit Ignat dhe gjithë këtyre njerëzve që shërbyen me sakrifica në këtë kohë të vështirë, janë një shpresë dhe kurajo dhe për ne se ata luten pranë Zotit për ne, dhe ne lutemi vazhdimisht për ta.

I përjetshëm kujtimi”!

Le të lutemi që shpirti i tij të prehet në paqe të amëshuar, dhe le të jetojmë me frymën që ai na la trashëgim: me besim, dashuri dhe përkushtim ndaj njëri-tjetrit.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)